

Bordit Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.13 dhe 514 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 dhe 1.21 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, si dhe në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për lartësinë dhe mënyrën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar, e miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8656/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 12.08.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Duke u bazuar në Raportin e Përzgjedhjes të datës 05.08.2025 të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave për Sigurimin e Përgjegjësisë Profesionale, **miratohet** përzgjedhja e kompanisë së sigurimeve **Scardian** për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar.
2. Autorizohet Kryetari i Odës që, në emër të OIRK-së, të nënshkruajë marrëveshjen me kompaninë e përzgjedhur të sigurimeve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në raport dhe kërkesat e Rregullores së OIRK-së.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në faqen zyrtare të OIRK-së.

Arsyetim:

Përzgjedhja e kompanisë së sigurimeve **Scardian** bazohet në ofertën financiare më të favorshme në të gjitha nivelet e mbulueshmërisë, përshkrimin e plotë dhe të qartë të mbulueshmërisë sipas Rregullores së OIRK-së, si dhe sigurimin e mbrojtjes ligjore efektive për inxhinierët anëtarë të OIRK-së.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për Sigurimin e Përgjegjësisë Profesionale

RAPORT I PËRZGJEDHJES SË KOMPANISË SË SIGURIMEVE

Baza ligjore:

Ky raport hartohet në mbështetje të Nenit 7 të *Rregullores për lartësinë dhe mënyrën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar* të OIRK, e cila përcakton se sigurimi i përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar që është anëtar i Odës bëhet përmes marrëveshjes së Odës me një kompani të licencuar të sigurimit.

Përbërja e Komisionit:

- Afrim Demiri – Kryesues
- Arsim Rapuca – Anëtar
- Mimoza Shahini – Anëtare

Procedura e ndjekur:

Materiali për ofertim, i cili përmbante kërkesat dhe specifikimet sipas *Rregullores së OIRK*, është dërguar tek të gjitha kompanitë e licencuara të sigurimit në Republikën e Kosovës.

Brenda afatit kohor të përcaktuar për dorëzim, ofertat i kanë dorëzuar pesë kompani të sigurimeve: Eurosig, Sigal, Scardian, Elsig dhe Iliria.

Pas pranimit të ofertave fillestare, u evidentuan disa paqartësi nga disa kompani të sigurimeve lidhur me përshkrimin e mbulueshmërisë dhe interpretimin e kërkesave të *Rregullores*. Për këtë arsye, Komisioni zhvilloi takime dhe komunikime me të gjitha kompanitë pjesëmarrëse për dhënie sqarime shtesë.

Pas këtyre sqarimeve, të gjitha kompanitë kanë dorëzuar ofertat e tyre finale për sigurimin e përgjegjësisë profesionale, duke përfshirë:

- Mbuleshmëri për 20,000€, 50,000€ dhe 100,000€.
- Prime për kontrata 1-vjeçare dhe 5-vjeçare (pagesë e menjëhershme).

Tabela krahasuese e ofertave

Kompania	20,000€ (1 vit)	50,000€ (1 vit)	100,000€ (1 vit)	20,000€ (5 vjet)	50,000€ (5 vjet)	100,000€ (5 vjet)
Eurosig	40€	75€	100€	Pa ofertë	Pa ofertë	Pa ofertë
Sigal	35€	80€	150€	150€	350€	650€
Scardian	21.24€	53.10€	106.20€	106.20€	260€	530€
Elsig	20€	50€	100€	100€	250€	500€
Iliria	90€	175€	Pa ofertë	Pa ofertë	Pa ofertë	Pa ofertë

Kriteret e vlerësimit:

- Oferta financiare.
- Qartësia dhe shtrirja e mbulueshmërisë së ofruar.
- Mundësia për kontrata afatshkurtra dhe afatgjata.
- Përputhja me kërkesat e Rregullores së OIRK.

Analiza:

Edhe pse Elsig ka ofruar prime pak më të ulëta në disa pozicione, oferta e saj nuk përmban përshkrimin e mbulueshmërisë sipas kërkesave të Rregullores së OIRK. Në anën tjetër, Scardian ka ofruar një ofertë financiare të favorshme, e shoqëruar me përshkrim të plotë dhe të qartë të mbulueshmërisë, në përputhje të plotë me Rregulloren e OIRK.

Arsyetimi i përzgjedhjes:

Pas shqyrtimit të të gjitha ofertave, Komisioni ka konstatuar se **Scardian** përmbush më së miri kriteret e përgjithshme të përcaktuara, duke ofruar:

- Oferta financiare të favorshme në të gjitha nivelet e mbulueshmërisë.
- Përshkrim të plotë dhe të qartë të mbulueshmërisë sipas Rregullores së OIRK.
- Siguri më të madhe ligjore dhe mbrojtje efektive për inxhinierët anëtarë të OIRK.

Përfundim:

Komisioni, me unanimitet, rekomandon që kontrata për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të lidhet me kompaninë e sigurimeve **Scardian**.

Nënshkrimet:

Afrim Demiri, Kryesues i Komisionit:

Arsim Rapuca, Anëtar:

Mimoza Shahini, Anëtare:

Data: 05 gusht 2025

Vendi: Prishtinë